



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:213444
Datë: 05.09.2024
Numri i dokumentit: 06126603

K.Dh.Shk.II.nr.1507/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit "C..." SHPK, me numër unik identifikues, me seli në Suharekë, me adresë ne Rr." p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Valdrin Behrami, me seli të zyrës në Prishtinë, kundër kundërshtares së masës së sigurimit Komunës së Prishtinës me adresë në Rr. "UÇK" Nr.2, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson zyrtari ligjor i komunës D.GJ. për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.753/23, i datës 01.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.04.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kundërshtarit të sigurimit Komunës së Prishtinës me seli në Prishtinë dhe **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr. 753/23, i datës 01.07.2024, ashtu që; **REFUZOHET** propozimi për caktimin e masës së sigurisë e propozuesit "C..." SHPK, me seli në Suharekë si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim:

“I.APROVOHET në tërësi si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit ”C...” SHPK, me numër unik identifikues, me seli në Suharekë, me adresë ne Rr.” p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Valdrin Behrami, me seli të zyrës në Prishtinë. II. Caktohet Masa e Sigurimit për kundërshtaren e masës së sigurimit Komunën e Prishtinës me adresë në Rr. ”UÇK” Nr.2, e të cilën sipas autorizimit e përfaqëson zyrtari ligjor i komunës D.GJ., ashtu që i Ndalohet ekzekutimi i sigurimit të tenderit me numër 114454, me datë të lëshimit 20.06.2023, në vlerë prej 19,197.59 euro, deri në një vendim tjetër të gjykatës.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit kundërshtari i masës se sigurimit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Dhomës së Shkallës së Dytë që të aprovojë ankesën si të bazuar të anulohet aktvendimin KE.nr. 753/23, i datës 01.07.2024, dhe aktvendimin e ankimuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet si e pa bazuar kërkesa për caktimin e masës së sigurisë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitë propozuesi i masë së sigurisë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditurit-kundërpropozuesit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, përgjigjes në ankesë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë ”C...” SHPK , me seli në Suharekë, me adresë ne Rr. p.n, me datën 12.09.10.2023 pranë gjykatës së shkallës së parë

kanë paraqitur padi, njëherit ka paraqit edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit Komunes së Prishtinës me adresë në Rr. "UÇK" Nr.2, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe t'i ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të ekzekutoj sigurimin e tenderit me numër 114454 datës 20.06.2023 në vlerë prej 19,197.59 euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendim, e ka aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, me arsyetim se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së. Ndër të tjera ka theksuar se bazuar në provat të cilat gjinden në shkresa të lëndës gjatë shikimit të tyre rezultojnë se me krijimin e rrethanave të reja ka ardhur deri të pengesat të cilat kanë pasur efekt në mos realizimin e punimeve në afate të caktuara siç ishte paraparë me kontratën publike kornize, ndërsa kundërpropozuesi nuk ka arritur të dëshmojë në këtë fazë të procedurës se është e domosdoshme konfiskimi i garancionit për shkak të mos realizimit të punimeve të parapara me kontratë, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate është krijuar besueshmëria se pretendimi i propozuesit për konfiskimi i garancioni me pretendimin se nuk kanë përfunduar punimet në afatin e paraparë me kontratë mund të rezultojë si i bazuar. Pavarësisht faktit se në rastin konkret është përcaktuar se garancioni do të ekzekutohet me kërkesën e parë të autoritetit kontraktues, i njëjti përbën garancion me kusht, për ekzekutimin e të cilit kërkohet që të vërtetohet në mënyrë objektive, dështimi i operatorit ekonomik në ekzekutimin e kontratës dhe shkaktimi i dëmeve autoritetit kontraktues si pasojë e mos ekzekutimit të të njëjtës, nga e cila rezultojnë se kërkesa e propozuesit të masës së sigurimit, për ndalimin e ekzekutimit të sigurimit të ekzekutimit të tenderit është e bazuar, për faktin se me asnjë provë kundërshtari i masës së sigurimit, nuk ka arritur që ta vërtetojë faktin se është plotësuar njëri nga kushtet e përcaktuara në këtë garancion, përkatësisht që të njëjtit në këtë fazë të procedurës i takon e drejta për ekzekutimin e garancionit. Po ashtu ka cek se propozuesi e ka bërë të besueshëm kërkesën për caktimin e masës së sigurimit dhe ekzekutimin e rrezikut se pa caktimin e një mase të tillë të njëjtit mund të shkaktohet dëm vështirë i riparueshëm.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore

nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, por gjendja faktike dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së dhomës së shkallës së parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke shqyrtuar ankesat e kundërpropozesit të masës së sigurisë brenda kufijve, gjeti se propozuesi “C...” SHPK, me seli në Suharekë, ka paraqitë propozim për caktimin e masës së sigurisë në Dhomën e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale. Propozimin e ka paraqit s’bashku me kërkesëpadi me të cilën ka kërkuar në emër të mos përmbushjes së kontratës kompenzimin e dëmit dhe fitimit e humbur.

Për caktimin e masës së sigurisë sipas dispozitës së nenit 297.1 nënpikën a) dhe b) të LPK-së kërkohen që të plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative që do të thotë se njëra prej tyre nuk plotësohet atëherë masa e sigurisë nuk mund të caktohet. Në këtë çështje kontestuese në mesë palëve është fakti se me ekzekutimin sigurimin e tenderit - garancionit, më hollësisht të përshkruara në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar a do të mund të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsytim lidhur me këtë fakt kontestues, se pse vështirësohet apo pamundësohet dukshëm realizimi i kërkesëpadisë nëse kjo masë e sigurisë nuk shqiptohet kur është e ditur se kundërshtari i propozimit është institucion shtetëror dhe ka buxhet të konsoliduar dhe të përhershëm.

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës së cilën vec e vec e edhe lidhshmërinë e tyre Gjykata e Dhomës së Shkallës së Dytë ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, që do të thotë e ka refuzuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë e më hollësisht e përshkruar në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e Dhomës së Shkallës së dytë thekson se nuk janë përmbush kushtet e parapara me nenin 297.1 nënpikë a) dhe b) për caktimin e masës së sigurisë ngase propozuesi nuk ka arrit të bëjë të besueshëm kërkesën e saj e sidomos faktin se pa masën e sigurimit vështirësohet në mënyrë të dukshme apo pamundësohet realizimi i kërkesëpadisë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së dytë konsideron dhe thekson se po që se propozuesi e realizon kërkesëpadin e vet atëherë e realizon edhe shumën prej 19.197.59euro, të deponuar si garancion në rast të mosëpërbushjes së kontratës edhe atë me kamatë ligjore nga dita e deponimit të padisë pranë gjykatës.

Në rastin konkret, sikurse e kemi cek edhe më lartë kundërpropozuesi është institucion shtetëror dhe burimet e saja financiare janë nga të hyrat vetanake të saj dhe nga buxheti i Republikës së Kosovës, kështu që realizimi i kërkesëpadisë së propozuesit nëse ajo vendoset me aktgjykim të formës së prerë janë qartësisht e realizueshme pa ndonjë vështirësi. E po që se propozuesi dështon të realizoi kërkesëpadinë përmes gjykatës pse duhet garancionin ta humbë vlerën e vet financiar. Andaj e gjitha varet nga epilogu që do të mirët për çështjen kryesore.

Kështu, nga arsyet e cekura Dhoma e Shkallës së Dytë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 194, 209 paragrafi 1 pika (c) e lidhur 201 pika (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1507/24, me datën 04.09.2024

Kryetare e kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri